

The School District of Philadelphia
Zyra e të drejtave dhe përgjegjësi të studentit
440 N. Broad Street, Second Floor
Philadelphia, PA 19130
Zyra: 215.400.4830 ~ Faks: 215.400.4226

Rachel Holzman, Esquire
Zëvendës Shef

Njoftim për të drejtat sipas Protection of Pupil Rights Amendment (Amendamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Studentit) (PPRA)

PPRA u jep prindërve dhe studentëve të shkollave fillore dhe sekondare disa të drejta të caktuara lidhur me kryerjen e anketave, mbledhjen dhe përdorimin e informacionit për qëllime marketingu dhe disa ekzaminime fizike të caktuara. Ndër to përfshihen e drejta për:

- Aprovim para se studentëve t'u kërkohet të paraqesin një anketë që ka të bëjë me një ose disa prej fushave të mbrojtura të mëposhtme ("anketa e informacionit të mbrojtur") nëse anketa financohet plotësisht ose pjesërisht nga një program i U.S. Department of Education (Departamenti Amerikan i Arsimit) (ED) -
 1. Lidhje ose bindje politike të studentit ose prindit të studentit;
 2. Probleme mendore ose psikologjike të studentit ose familjes së studentit;
 3. Sjellje ose qëndrime lidhur me seksin;
 4. Sjellje të ndaluara, anti-sociale, vetë-inkriminuese ose fyese.
 5. Vlerësime kritike të të tjerëve me të cilët të anketuarit kanë lidhje familjare;
 6. Marrëdhëniet e privileguara të njohura ligjërisht, si për shembull me avokatë, mjekë ose ministra;
 7. Praktika, besime ose bindje fetare të studentit ose prindit të studentit; ose
 8. Të ardhura, përveç atyre që kërkohen me ligj për të përcaktuar pranueshmërinë në program.

- Marrje e njoftimit dhe mundësi për të përjashtuar studentin nga -
 1. Çfarëdo anketë tjetër e informacionit të mbrojtur, pavarësisht se nga financohet;
 2. Çdo ekzaminim ose kontroll fizik joemergjent, invaziv që nevojitet si kusht i pjesëmarrjes, i kryer nga shkolla ose nga agjenti i tij, dhe që nuk është i nevojshëm për të mbrojtur me ngut shëndetin dhe sigurinë e një studenti, përveçse për kontrollet e dëgjimit, shikimit ose skoliozës, ose çdo ekzaminim ose kontroll fizik që lejohet ose kërkohet sipas ligjit të shtetit; dhe
 3. Aktivitete që përfshijnë mbledhjen, zbulimin ose përdorimin e informacionit personal të mbledhur nga studentët për marketing ose për të shitur apo për t'ua shpërndarë informacionin të tjerëve. (Kjo nuk vlen për grumbullimin, zbulimin ose përdorimin e informacionit personal të mbledhur nga studentët vetëm për qëllim të zhvillimit, vlerësimit ose ofritit të produkteve ose shërbimeve arsimore për studentët ose institucionet arsimore.)

- Inspektimi, me kërkesë dhe para administrimit ose përdorimit -
 1. Anketa të informacionit të mbrojtur të studentëve dhe anketa të krijuara nga një

- palë e tretë;
2. Instrumentet e përdorura për të mbledhur informacion personal nga studentët për cilëndo nga qëllimet e mësipërme të marketingut, shitjes ose shpërndarjes; dhe
 3. Material mësimor i përdorur si pjesë e planit arsimor.

Këto të drejta transferohen nga prindërit te një student që është mbi 18 vjeç ose te një i mitur i emancipuar sipas ligjit të shtetit.

Rrethi shkollor ka zhvilluar dhe adoptuar politika, në konsultim me prindërit, lidhur me këto të drejta, si edhe masa për të mbrojtur privatësinë e studentëve në administrimin e anketave të informacionit të mbrojtur dhe mbledhjen, zbulimin ose përdorimin e informacionit personal për qëllime marketingu, shitjeje ose për qëllime të tjera shpërndarjeje. Politika e Bordit të Rrethit Shkollor 235.1 (Anketat e studentëve) flet për të drejtat e prindërve/kujdestarëve dhe studentëve për sa u përket anketave të studentëve. Kur një anketë përmban kërkesa për informacion të mbrojtur, prindërit/kujdestarët kanë të drejtën që të informohen lidhur me këto anketa që u bëhen studentëve dhe kanë të drejtën të inspektojnë, me kërkesë, këtë anketë para se të kryhet ose t'u shpërndahet studentëve. Prindërit/kujdestarët kanë gjithashtu të drejtën që fëmija i tyre të përjashtohet nga anketat në të cilat kërkohet informacion i mbrojtur.

Rrethi shkollor do të njoftojë gjithashtu drejtpërdrejt, si për shembull nëpërmjet U.S. Mail ose me email, prindërit e studentëve të cilët janë planifikuar të marrin pjesë në aktivitete ose në anketa specifike që tregohen më poshtë dhe prindit do t'i jepet mundësia që të mos lejojë pjesëmarrjen e fëmijës së tij ose të saj në në aktivitetin ose në anketat specifike. Prindërve do t'u jepet gjithashtu mundësia që të rishikojnë çdo anketë përkatëse. Për anketat dhe aktivitetet e planifikuara pasi të fillojë viti shkollor, prindërve do t'u jepet njoftim i arsyeshëm për aktivitete dhe anketat e planifikuara që tregohen më poshtë dhe do t'u jepet mundësia të mos lejojnë përfshirjen e fëmijës së tyre në këto aktivitete dhe anketa. Prindërve do t'u jepet gjithashtu mundësia që të rishikojnë çdo anketë përkatëse. Më poshtë është një listë e aktiviteteve dhe anketave specifike që mbulohen në këtë kërkesë për njoftim të drejtpërdrejtë:

- Mbledhja, zbulimi ose përdorimi i informacionit personal të mbledhur nga studentët për marketing, shitje ose qëllime të tjera shpërndarjeje.
- Kryerja e anketave të informacionit të mbrojtur që nuk financohet pjesërisht ose pjesërisht nga ED.
- Çdo ekzaminim ose kontroll fizik joemergjent, invaziv siç tregohet më sipër.

Prindërit që besojnë se u janë shkelur të drejtat mund të paraqesin ankesë te:

Zyra e politikës për privatësinë e studentit
U.S. Department of Education (Departamenti Amerikan i Arsimit)
400 Maryland Avenue, SW
Washington, DC 20202